



ANALIZA DHE HULUMTIMI PËR NIVELIN E PESTË TË KUALIFIKIMEVE ARSIMORE NË SHKOLLAT E AAP NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Ky dokument është përgatitur nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe
Arsim për të Rritur, në mbështetje financiare nga DVV-International



AAAPARR
KORRIK, 2018
Prishtinë



Hulumtimi u përgatit nga Ekspertët

- Fikrije Zymberi
- Jetmir Berisha
- Muhamer Ibriqi
- Safete Bajraktari

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA	2
Lista e figurave – grafikëve	3
Lista e tabelave	3
Lista e shkurtesave	4
1. PARATHËNIE	6
1.1. Bashkëpunimi i DVV International me AAAPARR	9
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	11
3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	13
4. DOKUMENTE RELEVANTE NË VEND QË RREGULLOJNË NIVELIN E PESTË TË KUALIFIKIMEVE	15
5. PËRGATITJA E PYETËSORIT	18
6. ANALIZA E PËRGJIGJEVE TË PYETËSORIT	22
6.1. “Çka nënkuptoni me nivelin e pestë të kualifikimeve?”, pyetja 1	24
6.2. “Sa keni njohuri për legjislacionin në fuqi që rregullon nivelin e pestë të kualifikimeve”, pyetja 2	25
6.3. “A mendoni se është i rëndësishëm niveli i pestë i kualifikimeve?”, pyetja 3	26
6.4. “Sa mendoni se është i rëndësishëm ofrimi i nivelit të pestë të kualifikimeve?”, pyetja 4	27
6.5. “A duhet të nxirren akte tjera ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë nivel të kualifikimeve, /Po, Jo/. Nëse po, cilat mund të jenë ato?”, pyetja 5	28
6.6. “Cilat kapacitete të stafit të mësimdhënësve mendoni se duhet të ngriten për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve në institucionin tuaj?”, pyetja 6	29
6.7. “Sa mendoni se duhet të ngriten kapacitetet e stafit mësimdhënës për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve në institucionin tuaj?”, pyetja 7	30
6.8. “Cilët profile konsideroni si më të përshtatshëm apo më të kërkuar në tregun e punës, sa i përket nivelit të pestë të kualifikimeve?”, pyetja 8.....	31
6.9. “Me kryerjen e nivelit të pestë të kualifikimeve, sa mendoni se një kandidat do të jetë më konkurrues për t’u pozicionuar në tregun e punës?”, pyetja 9.....	33
6.10. “A mendoni se institucioni juaj ka kapacitete të mjaftueshme për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve, /Po, Jo/, nëse po, në cilët profile?”, pyetja 10	34
6.11. “Sa është e gatshme shkolla juaj të ofroj nivelin e pestë të kualifikimeve?”, pyetja 11	35
6.12. “A ka ofruar ose a ofron institucioni juaj nivelin e pestë të kualifikimeve, /Po, Jo/, nëse Po, në cilët profile?”, pyetja 12	36
6.13. “A mendoni se ekziston bazë e mjaftueshme ligjore sa i përket rekrutimit të mësimdhënësve dhe instruktorëve për nivelin e pestë të kualifikimeve?”, pyetja 13.....	37

6.14.	“A mendonin se kompanitë me të cilat bashkëpunon institucioni juaj do të jenë të interesuara të thellojnë bashkëpunimin në pranimin e kandidatëve për kryerjen e praktikës profesionale edhe në nivelin e pestë të kualifikimeve”?, pyetja 14.....	38
6.15.	“Çfarë lloje trajnimesh mendoni se nevojiten për mësimdhënësit që do të ligjërojnë në këtë nivel”?, pyetja 15 39	
7.1.	Intervistat e realizuara	41
8.	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	48

Lista e figurave – grafikëve

Figura 1.	Shpërndarja territoriale e shkollave të AAP-së, pjesëmarrëse në hulumtim.	23
Figura 2.	Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me njohuritë për legjislacionin në fuqi që rregullon nivelin e pestë të kualifikimeve.....	25
Figura 3.	Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me rëndësinë e nivelit të pestë të kualifikimeve.....	26
Figura 4.	Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me rëndësinë e ofrimit të nivelit të pestë të kualifikimeve.....	27
Figura 5.	Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me nevojën e nxjerrjes së akteve tjeraa ligjore dhe nënligjore që rregullojnë nivelin e pestë të kualifikimeve.....	28
Figura 6.	Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me nevojën e ngritjes së kapaciteteve të stafit të mësimdhënëse por të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve.	30
Figura 7.	Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me konkurrueshmërinë e kandidatëve në treun e punës pas kryerjes së nivelit të pestë të kualifikimeve.....	33
Figura 8.	Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me gatishmërinë e shkollave për ofrimin e nivelit të pestë të kualifikimeve.....	35
Figura 9.	Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me mjaftueshmërinë e bazës ligjore sa i përket rekrutimit të mësimdhënësve dhe instruktorëve në nivelin e pestë të kualifikimeve.....	37

Lista e tabelave

Tabela 1.	Përgatitja e formatit të pyetësorit.....	20
-----------	--	----

Lista e shkurtesave

MAShT	- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
AAAPARr	- Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur
AKK	- Autoriteti Kombëtar i kualifikimeve
IPK	- Instituti Pedagogjik i Kosovës
DKA	- Drejtorati komunal i Arsimit
QK (QeK)	- Qendra e Kompetencës
Shmlp	- Shkollë e Mesme e Lartë Profesionale
Shmlt	- Shkollë e Mesme e Lartë Teknike
IAAP	- Institucion i Arsimit dhe Aftësimit Profesional
IAL	- Institucion i Arsimit të Lartë
DVV	- DVV-International (Instituti për bashkëpunim ndërkombëtar të bashkësisë të shkollave të larta popullore Gjermane)
ETF	- European Training Fondation
CEDEFOP	- European Center for the Development of Vocational Training
ILO	- International Labour Office
SKZh	- Strategjia Kombëtare për Zhvillim
KKK	- Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
PSAK	- Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
MTPT	- Ish Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit
MI	- Ministria e Infrastrukturës



- UA - Udhëzim Administrativ
- INK - Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit
- IUK - Instalues i ujësjellësit dhe Kanalizimit
- TIK - Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit

1. PARATHËNIE

Sistemi i arsimit në Kosovë viteve të fundit po bënë përpjekje më të mëdha që ndryshimet në drejtim të përmirësimit të gjendjes të jenë më të shpejta. Sa më parë që arrihet përbushja e një numri të konsiderueshëm të sfidave dhe nevojave të ekonomisë së tregut aq më shumë do t'i afrohem përbushjes së objektivave që dalin nga dokumente të shumta të përgatitura nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe institucioneve relevante në vend, jo rrallë të ndihmuara nga ekspertiza e vendeve më të zhvilluara të Bashkimit Evropian. Shumica e dokumenteve ekzistuese në lidhje me arsimin në Kosovë e sidomos dokumentet e përgatitura për arsimin dhe aftësimin profesional dhe arsimin për të rritur theksojnë nevojën e bashkëpunimit më të madh ndërmjet shkollave profesionale dhe komunitetit të bizneseve nëpër regjionet ku ato ndodhen, me qëllim të përshtatjes sa më të madhe të ofertës së profileve arsimore në shkollat profesionale me kërkesën e sektorëve ekonomik më të zhvilluar në ato regjione.

AAAPARr si institucion i ri ka për synim që të mbështesë në mënyrë të fuqishme zhvillimin e AAP-së në Kosovë, që në përputhje me standardet evropiane të mundësojë:

- Përbushjen e nevojave të tregut të punës krahas ndryshimeve të zhvillimit të teknologjisë moderne dhe zhvillimit ekonomik e social të vendit;
- Sigurimin e partneritetit social në të gjitha nivelet dhe në të gjitha fazat e planifikimit, zhvillimit dhe zbatimit të programeve të AAP-së;
- Integrimin e arsimit, formimit dhe punës në këndvështrimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës;
- zhvillimin e dimensionit Evropian të AAP-së, duke siguruar një transparencë të kualifikimeve dhe përafrimit të kompetencave me tregun e përbashkët Evropian.

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) në Kosovë që nga fillimi i vitit 2016 është anëtare e Asociacionit Evropian të Instituteve për Aftësim Profesional (EVBB) me seli në Bruksel e cila është organizatë ombrellë, anëtare

të të cilës janë organizata dhe Institucione të ndryshme shtetërore nga vendet e ndryshme Evropiane, institute koordinuese të arsimit dhe ofruesit e arsimit në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Objektiva kryesore e punës së EVBB-së është përmirësimi i cilësisë të arsimit dhe aftësimin profesional në vendet Evropiane, krijimi i mundësive dhe kushteve për një fuqi punëtore mobile me shkathtësi të duhura profesionale sipas kërkesave të tregut Evropian.

Duke qenë të vetëdijshëm për sfidat e reja në gjithë botën, për dukuritë me ndikim shumë të madh në zhvillimet arsimore, ekonomike, sociale, politike, themelimi i AAAPARr-së vie si përgjigje e këtyre zhvillimeve. Kosova është këmbëngulëse në udhën e reformimit të arsimit dhe aftësimin profesional me qëllim që kjo pjesë e sistemit arsimor të Kosovës t'i kultivojë shkathtësitë e punës. Prandaj, agjencia ka marrë obligim që shkollat profesionale ta bëjnë përgatitjen e kadrove për treg të punës dhe të ofrojnë mundësinë për studime më të larta post-sekondare dhe universitare, pasi që vendimit për themelimin e Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur i ka paraprirë synimi për reformimin e sektorit të arsimit profesional, me qëllim që shkathtësitë e fituara të nxënësve dhe kompetencat e tyre të jenë ekuivalente me ato të bashkëmoshatarëve të tyre që dalin nga sistemet arsimore të shteteve të BE-së. Në vitet e fundit, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), e mbështetur nga donatorët, ka reformuar sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë dhe si rezultat i këtyre reformave, janë themeluar qendrat e kompetencës të financuara nga Qeveria e Norvegjisë dhe ajo e Luksemburgut. Qendrat e kompetencës dallojnë nga shkollat profesionale për nga infrastruktura moderne, pajisjet, cilësia e mësimdhënies, realizimi i aftësimin praktik të nxënësve, bashkëpunimi me bizneset, zbatimin e kurrikulave modulare, bashkëpunimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare si dhe në zhvillimin e modelit të biznesit. Deri më tani, në Kosovë ekzistojnë gjashtë shkolla profesionale nën menaxhimin e AAAPARr-së: Shmlp “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë, Shmlt “11 Marsi” në Prizren, Qendra e Kompetencës në Skenderaj, Qendra e Kompetencës në Malishevë, Qendra e Kompetencës në Ferizaj dhe Qendra e Kompetencës në Prizren, të cilat kanë edhe rolin multifunksional pasi, përveç programeve të rregullta trevjeçare, ofrojnë edhe kurse të shkurtra për të gjithë

të rriturit të cilët kanë nevojë të marrin një kualifikim të ri, të rikualifikohen apo t'i avancojnë njohuritë dhe kompetencat e tyre dhe t'u përgjigjen nevojave të tregut të punës. Si rrjedhojë e kësaj, për herë të parë në sistemin formal të arsimit në Kosovë, AAAPARr ka startuar nivelin e pestë të kualifikimit “Asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore” dhe “Këshilltar në karrierë” që janë zhvilluar nga PEARSON, institucion prestigjioz britanik, ndërsa është financuar dhe projekti nga “Lux Development”.

Së fundmi, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) në bashkëpunim me zyrën e institutit për bashkëpunim ndërkombëtar të bashkësisë të shkollave të larta popullore gjermane në Kosovë, të njohur si DVV International, filloi implementimin e projektit të hulumtimit për nivelin e V-të arsimor të kualifikimeve, në fushën e Arsimit dhe Aftësimin Profesional, sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në Kosovë. Ky hulumtim fokus të veçantë ka analizën dhe hulumtimin e nevojave në teren për të siguruar implementimin e nivelit të V-të të kualifikimeve në kuadër të shkollave të mesme profesionale dhe Qendrave të Kompetencës në Kosovë.

Organizata e cila ka ofruar buxhetin e nevojshëm për realizimin e hulumtimit „Analiza e nevojave në teren për të filluar me implementimin e nivelit 5 të kualifikimeve në kuadër të shkollave të mesme profesionale dhe Qendrave të Kompetencës në Kosovë” është Instituti për bashkëpunim ndërkombëtar i bashkësisë së shkollave të larta popullore gjermane (DVV International).

1.1. Bashkëpunimi i DVV International me AAAPARr

DVV International në Kosovë është duke mbështetur dhe zhvilluar edukimin e të rriturve që nga viti 2005. Qëllimi i DVV International është ndërtimi i një sistemi arsimor efektiv dhe cilësor për arsimin e të rriturve dhe mësimin gjatë gjithë jetës.

DVV International mbështet përpjekjet shtetërore në mbarë botën për të siguruar dhe implementuar strategjitë e arsimit të të rriturve si mjet në luftën kundër varfërisë. Prandaj DVV International në Kosovë kualifikon vendimmarrësit në angazhimin e tyre me çasjet rajonale dhe ndërkombëtare si pjesë e procesit të vazhimit të Konventës ndërkombëtare VI - Konferenca Ndërkombëtare për Arsimin e të Rriturve - por edhe në lidhje me kërkesat që dalin nga perspektiva e anëtarësimit në BE. Çështjet kryesore këtu janë financimi i arsimit të të rriturve përmes buxhetit publik, rritja e cilësisë dhe mundësive për të mësuarit e të rriturve (validimi dhe akreditimi i institucioneve dhe kurseve), si dhe sigurimi i pjesëmarrjes jodiskriminuese dhe gjithëpërfshirëse të të rriturve në procesin arsimor .

Fokusi kryesor i punës së DVV International në bashkëpunim me Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsimin e të Rriturve në Kosovë (AAAPARr) është i orientuar në trajnimin mësimdhënësve dhe trajnerëve në metodologjinë dhe didaktikën e arsimit të të rriturve me qëllim që të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të arsimit profesional për të rritur në kuadër të shkollave të mesme profesionale dhe qendrave të kompetences. DVV International në bashkëpunim me AAAPARr është duke u angazhuar edhe në përmirësimin dhe zhvillimin e kurrikulave dhe programeve të reja për arsimin e të rriturve në mesin e të cilave janë edhe programet modulare për nivelin 5 të kualifikimeve të cilat me një bashkëpunim të mirë ndërmjet ministrive kompetente, OJQ-ve, Kompanive dhe institucioneve private të arsimit, mund të fillojnë të implementohen në shkollat e mesme profesionale dhe qendrat e kompetencës në Kosovë.



Në vitet e fundit jo vetëm në vendin tonë por në përgjithësi në nivel global tregjet po pësojnë një lëvizje mjaftë dinamike dhe komplekse të punëve dhe të aftësive për të kryer punë, duke kërkuar përshtatje më të shpejtë dhe përputhje sa më të mirë të ofertës në shkollat e arsimit dhe aftësimit profesional me kërkesat e tregut të punës. Nevoja e të kuptuarit më të mirë të këtyre lëvizjeve dinamike në tregun e punës kryesisht vë në rezultat i zhvillimit të hovshëm të teknologjisë, duke ndikuar gjithashtu në një masë të madhe të ndryshimit të axhendave politike arsimore në shumë vende të botës.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Hulumtimi lidhur me nevojën e zbatimit të nivelit të pestë të kualifikimeve në shkollat profesionale në Republikën e Kosovës do të shërbejë për nevojat e AAAPARr-së, MASHT-it dhe akterëve tjerë në Kosovë, si një udhërrëfyes për zhvillimin e kurrikulave dhe programeve të nevojshme arsimore për këtë nivel të kualifikimeve, duke u bazuar në specifikat e tregut të punës në vend, me qëllim të ofrimit gjithashtu të informacioneve për nevojat e ndërtimit të kapaciteteve të shkollave të mesme profesionale. Realizimi i këtij hulumtimi bazohet në mbledhjen e të dhënave nga tereni nga një numer i caktuar i shkollave profesionale dhe Qendrave të Kompetencës, duke përfshirë të gjitha rajonet në Republikën e Kosovës, për të parë mundësitë e shkollave se sa janë në gjendje të fillojnë zbatimin e nivelit të V-të të kualifikimeve. Në vendin tonë ekzistojnë dokumente referente apo strategji të ndryshme në nivel qeveritar, ministror dhe komunal të cilat mundohen të orientojnë ecurinë e zhvillimit të arsimit e sidomos të arsimit profesional, duke paraqitur konkretisht misionin, vizionin, objektivat strategjike, masat dhe treguesit. Në dokumentet e tilla strategjike janë paraqitur gjithashtu planet e zbatimit të këtyre strategjive, duke paraparë buxhete, periudha të zbatimit, bartësit dhe prioritetet për secilën nga masat e parapara. Megjithatë mund të thuhet se në shumicën e këtyre dokumenteve nuk ka një trajtim të mjaftueshëm adekuat dhe konkret edhe për nivelin e pestë të kualifikimeve arsimore. Vlerësohet se ekzistojnë institucione të pakta publike dhe private të cilat ofrojnë programe trajnimi për nivelin e pestë të kualifikimeve në nivel vendi, kurse në takime të shumta të organizuara nga organizatat e ndryshme qeveritare dhe jo qeveritare si dhe nga organizatat e huaja relevante në vend, komuniteti i biznesit vazhdimisht ngrit zërin për nevojën e përgatitjes më të mirë të punëtorëve me shkathtësi të caktuara për sektorë të ndryshëm ekonomik dhe për nevojën e përmirësimit dhe ndryshimit të programeve ekzistuese arsimore në arsimin profesional.

Përmes këtij dokumenti tentohet të fillohet hapja e një dritareje informuese për gjendjen në të cilën ekziston ky nivel në arsimin profesional, me shpresën se në të ardhmen do të



kemi edhe hulumtime tjera në këtë drejtim, e posaçërisht hulumtime të thelluara më tepër në nevojën e ndërmarrjeve dhe raportet me ofertën e shkollave profesionale. Nismëtarët e kësaj iniciative (AAAPARr në bashkëpunim me DVV-International) janë të vetëdijshëm se kjo nismë nuk e plotëson në tërësi zbrazëtinë ekzistuese për informacionin e nevojshëm në lidhje me mundësinë e implemementimit të nivelit të pestë nëpër shkollat profesionale, pasi në të ardhmen do të jetë e domosdoshme të punohet gjithashtu me ndërmarrjet që operojnë në sektorë të ndryshëm ekonomik në nivel regjional dhe në nivel vendi.

3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Ky hulumtim është zhvilluar në formë anketimi, nëpërmjet pyetësorit dhe analizës, krahasimit e intervistës, i cili është hartuar posaçërisht për këtë qëllim nga ekspertët e angazhuar në këtë projekt dhe është aprovuar nga Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur. Me anë të këtij hulumtimi mblidhen të dhëna të rëndësishme nga Shkollat e AAP-së, lidhur me gjendjen në shkolla dhe mundësinë e zbatimit të nivelit të pestë të kualifikimeve në to. Këto të dhëna të mbledhura krijojnë mundësi për të bërë vlerësime, analiza dhe krahasime ndërmjet profileve të ofruara në kuadër të shkollave të AAP-së por edhe vetë mundësinë e sistemit arsimor aktual në Kosovë lidhur me këtë nivel.

Për këtë qëllim pyetësi është zhvilluar dhe përmban kërkesa për informacione të përgjithshme dhe specifike rreth gjendjes aktuale në shkollat e AAP-së dhe mundësitë reale për realizimin e nivelit të pestë. Pyetësi përmban gjithsej 15 pyetje të cilat janë dizajnuara në atë mënyrë që të jenë të ndërlidhura me njëra tjetrën.

Në fillim pyetësi përmban informata të përgjithshme lidhur me njohuritë që kanë shkollat në lidhje me nivelin e pestë të kualifikimeve në Kosovë, duke përfshirë njohuritë e përgjithshme për këtë nivel, legjislacionin që e rregullon dhe rëndësinë e tij për zbatim në shkollat e AAP-së.

Pastaj, pyetësi përmban informata tjera të rëndësishme lidhur me kapacitetet ekzistuese të stafit të mësimdhënësve në shkollat e AAP-së, të anketuara për këtë qëllim, përkatësisht vlerësimin nga ana e tyre lidhur me mundësinë e zbatimit të nivelit të pestë, duke përfshirë komponentën e mësimdhënies, e cila është mjaftë e rëndësishme për zbatim të këtij niveli.

Komponent tjetër i rëndësishëm i përfshirë në pyetësor është edhe analiza dhe marrja e informatave nga shkollat e AAP-së, lidhur me gatishmërinë e tyre për të zbatuar nivelin e

pestë të kualifikimeve në profile të caktuara për të cilat ka kapacitete të duhura shkolla, duke u bazuar edhe në kërkesat e tregut të punës.

Tutje në pjesën e fundit të pyetësorit gjithashtu ekzistojnë informata të rëndësishme që kanë dhënë shkollat e AAP-së për mundësinë e bashkëpunimit të shkollave me kompanitë lidhur me marrëveshjet për pranimin e kandidatëve që do të ndjekin këtë nivel, për mundësinë e kryerjes së praktikës profesionale. Gjithashtu përmes pyetësorit kërkohen informata lidhur me trajnimet që përfaqësuesit e shkollave mendojnë se duhet të kryhen nga ana e mësimdhënësve për të ligjëruar në këtë nivel.

Hulumtimi është zhvilluar dhe menaxhuar nga ekspertët e projektit të angazhuar nga AAAPARR dhe DVV-International në Kosovë. Për qëllim të hulumtimit është paraparë që të intervistohen edhe persona zyrtar nga institucionet relevante që merren me Arsim dhe Aftësim Profesional, përkatësisht që kanë zhvilluar dokumentacion apo që janë marrë me nivelin e pestë të kualifikimeve.

4. DOKUMENTE RELEVANTE NË VEND QË RREGULLOJNË NIVELIN E PESTË TË KUALIFIKIMEVE

Ndonëse në Kosovë niveli i pestë i kualifikimeve është një kualifikim relativisht i ri i cili ka filluar të zbatohet në arsimin publik dhe privat, ekzistojnë dokumente të cilat në mënyrë të fragmentuar e rregullojnë zbatueshmërinë dhe funksionimin e këtij niveli.

Në ligjin për Arsim dhe Aftësim Profesional Nr. 04/L-138, theksohet si arsim postsekondar përkatësisht kualifikimet dhe modulet që i takojnë nivelit të pestë të KKK-së, që janë profesionale apo akademike, që mund të ofrohen edhe nga institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional (IAAP).

Ligji për Kualifikime Kombëtare Nr. 03/L-060 thekson që MASHT apo edhe institucionet tjera përgjegjëse mund të kërkojnë programe publike të arsimit dhe aftësimin, që çojnë vetëm të kualifikimet e caktuara, të aprovuara nga AKK. Kjo rregullohet me akt nënligjor, që nxirret nga institucionet përgjegjëse.

Dokument i rëndësishëm që flet për mundësinë e zbatimit të nivelit të pestë të kualifikimeve, në kuadër të shkathtësive për punë është Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH), dokument zyrtar i Qeverisë së Kosovës, si plan për një zhvillim të qëndrueshëm. Në këtë dokument më tej thuhet se: Qeveria duhet të themelojë programe formale të AAP-së pas shkollës së mesme brenda Qendrave të Kompetencës me programe fleksibile për të përmbushur nevojat e ndryshimit dhe zhvillimit personal dhe për të inkurajuar shkollat që të ofrojnë kurse për të rriturit jashtë orarit normal të shkollës, sipas pagesës.

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK) është dokumenti kryesor për rregullimin e llojeve dhe niveleve të kualifikimeve që jepen në kuadër të sistemit të arsimit dhe aftësimin profesional formal dhe joformal në institucionet publike dhe private. Përpos niveleve tjera me KKK rregullohet edhe përshkrimi i nivelit të pestë, kriteret hyrëse dhe dalëse për këtë nivel. KKK është mekanizëm kombëtar për klasifikimin e kualifikimeve të dhëna brenda sistemit kombëtar të kualifikimeve, sipas llojeve të kualifikimeve dhe përshkruesve të nivelit.

Një dokument tjetër shumë i rëndësishëm në sistemin e arsimit në vend është edhe Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK), i MAShT. PSAK në kuadër të planifikimit të objektivave strategjike dhe masave të parapara për arritje, tek objektiva e 6-të për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, ndër sfidat kryesore potencon edhe “mungesën e ofertës shumë të kufizuar për nivelin e 5-të të KKK-së”

Te rezultatet e pritura në kuadër të PSAK parashihet që të rritet oferta e shkollimit në nivelin e 5-të të kualifikimeve, përmes:

- Identifikimit të nevojave për kualifikime të nivelit të 5-të,
- Zhvillim të programeve të reja për arritjen e kualifikimeve në nivelin e 5-të post-sekondar,
- Ofrimin e programeve të reja të nivelit të 5-të post-sekondar ne IAAP, veçanërisht në Qendrat e Kompetencës.

Qendrat e Kompetencës (QeK), që menaxhohen nga AAAPARr, janë një koncept i ri i institucioneve të AAP-së që kanë për qëllim lehtësimin e procesit të shmangies nga kurrikula e bazuar në përmbajtje në kurrikulë të bazuar në kompetenca, duke siguruar një përgatitje të shkëlqyer për tregun e punës. Qendrat kanë objekte të shkëlqyera, lidhje të mira me tregun e punës, dhe janë menduar të shërbejnë si modele për shkollat profesionale në Kosovë dhe rajon.

Gjithashtu, ekziston Udhezimi Administrativ (Nr. 07/2017, në MAShT) për themelimin e marrëdhënies së punës për Mësimdhënësit dhe Instruktorët e nivelit të 5-të, i cili rregullon themelimin e marrëdhënies së punës për mësimdhënësit dhe instruktorët e nivelit 5 të institucioneve të Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP) dhe institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL).

Siç shihet, ekzistojnë institucione dhe dokumente relevante që merren me nivelin e 5-të arsimor të kualifikimeve por nuk kemi arritur akoma të kemi nje politik te qartë dhe

dokumente të harmonizuara nga akterët relevant që do të shërbenin për zbatimin në mënyrë të duhur të këtij niveli.

Në funksion të kësaj, këtij hulumtimi paralelisht është duke i prirë tash së fundmi edhe iniciativa që ka filluar nga MASHT për hartimin e një Udhezimi Administrativ apo Rregullore për Organizimin e mësimdhënies në nivelin e 5-të të kualifikimeve, qëllimi i të cilit është rregullimi i ofrimit të nivelit të 5-të të kualifikimeve të IAAP-ve të MASHT-it.

5. PËRGATITJA E PYETËSORIT

Ekipi i hulumtimit (grupi i punës) ka ndërmarrë disa hapa në përgatitjen e formatit të pyetësorit dhe hartimin e pyetjeve në këtë pyetësor. Nga ana e ekipit janë trajtuar disa formate të pyetësorëve të përdorur në hulumtime të ndryshme, kurse në fund është vendosur që formati i këtij pyetësori t’i referohet dokumenteve që kanë të bëjnë me arsimin në përgjithësi. Prandaj, modeli i këtij formati të pyetësorit bazohet kryesisht në udhëzuesin për parashikimin e përshtatjes së aftësive të kandidatëve me kërkesat e tregut të punës, të përgatitur nga Fondacioni Evropian i Trajnimeve (ETF), në lidhje me kryerjen e studimeve hulumtuese. Udhëzuesi i tillë është përgatitur nga ETF në bashkëpunim me Qendrën Evropiane për Zhvillimin e Trajnimeve Profesionale (e njohur si CEDEFOP) dhe Zyrën Ndërkombëtare të Punës (e njohur si ILO). Dokumente tjera referente në të cilat është bazuar përgatitja e pyetësorit dhe hulumtimit në tërësi janë gjithashtu:

- ✓ Treguesit e arsimit në Kosovë, përgatitur nga MASHT;
- ✓ Raportet vjetor statistikor me tregues arsimor;
- ✓ Statistikat e arsimit në Kosovë;
- ✓ Arsimi dhe aftësimi i të rriturve në shkollat profesionale në Kosovë, raport studimi, përgatitur nga Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) dhe DVV-International;
- ✓ Korniza e treguesve të arsimit në Kosovë;
- ✓ Analizë e Hulumtimit – përfshirja e të rinjëve në zhvillimin e arsimit profesional, e përgatitur nga Iniciativa për Progres (INPO);
- ✓ Të dhënat për periudhën gjatë pilotimit, përgatitur nga AAAPARr.



Pas vendimit për formatin e pyetësorit, grupi i punës ka përgatitur pyetjet për pyetësor duke lënë mundësinë e përgjigjeve të hapura dhe të mbyllura në disa prej tyre. Draft-formati i pyetësorit dhe pyetjet e përgatitura janë diskutuar në një punëtori të veçantë të organizuar (nga AAAPARr nën mbështetjen financiare të DVV-International) enkas për këtë qëllim, ku pjesëmarrës në këtë punëtori kanë qenë përfaqësues nga MASHT, AAAPARr, DVV-





International, AKK, IPK dhe drejtorët apo përfaqësuesit e disave prej shkollave profesionale në Kosovë, përfshirë të gjitha regjionet e Kosovës. Grupi i punës ka mirëprit komentet dhe rekomandimet në lidhje me formatin e pyetësorit dhe pyetjet në pyetësor dhe njëkohësisht i ka përfshirë në rishikimin e tij. Pyetësori i është drejtuar pastaj vetëm shkollave profesionale, përkatësisht menaxhmenteve të shkollave profesionale të cilat kanë marrë pjesë në punëtori dhe njëherit kanë marrë informacionet dhe kanë kontribuar në lidhje me këtë pyetësor.

Në tabelën në vijim ndodhet pyetësori i cili i cili iu është drejtuar shkollave profesionale.

Tabela 1. Përgatitja e formatit të pyetësorit.

 																			
<p>Republika e Kosovës Republika Kosovo-Republic of Kosovo Qeveria –Vlada-Government MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION</p>																			
Pyetësor																			
<p>Analiza dhe hulumtimi i nevojave në terren për të siguruar implementimin e nivelit të pestë të kualifikimeve në kuadër të shkollave të AAP-së</p>																			
<p><i>Ky pyetësor iniciohet nga AAAPARr (Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur) në bashkëpunim me DVV-International, zhvillohet në shkollat e AAP-së (Arsimit dhe Aftësimin Profesional) dhe ka për qëllim marrjen e informacioneve në lidhje me analizën dhe hulumtimin e nevojave në terren për të siguruar implementimin e nivelit të pestë të kualifikimeve në kuadër të shkollave të mesme të larta profesionale.</i></p>																			
Emri i shkollës _____																			
Vendi: _____																			
<u>Nivelet e vlerësimit:</u>																			
<p><i>Ju lutemi jepni vlerësimin tuaj për pyetjet e shënuara në tabelën e mëposhtme. Vlerësimet të jepen bazuar në këto nivele vlerësimi: 1-Aspak; 2-Pak; 3-Mesatarisht; 4-Mirë; 5-Shumë. Gjithashtu, në disa prej pyetjeve kërkohet të jepen komente me shkrim.</i></p>																			
<p>Pyetësor për shkollat e mesme të larta profesionale. Analizë dhe hulumtim për nivelin e pestë të kualifikimit, bazuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.</p>																			
1	<p>Çka nënkuptoni me nivelin e pestë të kualifikimeve?</p> <hr/>																		
2	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 40%;">Sa keni njohuri për legjislacionin në fuqi që rregullon nivelin e pestë të kualifikimeve</td> <td style="width: 10%; text-align: center;">Aspak</td> <td style="width: 10%;"></td> <td style="width: 10%;"></td> <td style="width: 10%;"></td> <td style="width: 10%; text-align: center;">shumë</td> </tr> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">1</td> <td style="text-align: center;">2</td> <td style="text-align: center;">3</td> <td style="text-align: center;">4</td> <td style="text-align: center;">5</td> </tr> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> </tr> </table>	Sa keni njohuri për legjislacionin në fuqi që rregullon nivelin e pestë të kualifikimeve	Aspak				shumë		1	2	3	4	5		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Sa keni njohuri për legjislacionin në fuqi që rregullon nivelin e pestë të kualifikimeve	Aspak				shumë														
	1	2	3	4	5														
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>														
3	<p>A mendoni se është i rëndësishëm niveli i pestë i kualifikimeve?</p> <hr/>																		
4	<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="width: 40%;">Sa mendoni se është i rëndësishëm ofrim i nivelit të pestë të kualifikimeve</td> <td style="width: 10%; text-align: center;">Aspak</td> <td style="width: 10%;"></td> <td style="width: 10%;"></td> <td style="width: 10%;"></td> <td style="width: 10%; text-align: center;">shumë</td> </tr> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;">1</td> <td style="text-align: center;">2</td> <td style="text-align: center;">3</td> <td style="text-align: center;">4</td> <td style="text-align: center;">5</td> </tr> <tr> <td></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> <td style="text-align: center;"><input type="checkbox"/></td> </tr> </table>	Sa mendoni se është i rëndësishëm ofrim i nivelit të pestë të kualifikimeve	Aspak				shumë		1	2	3	4	5		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Sa mendoni se është i rëndësishëm ofrim i nivelit të pestë të kualifikimeve	Aspak				shumë														
	1	2	3	4	5														
	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>														
5	<p>A duhet të nxirren akte tjera ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë nivel të kualifikimeve, /Po, Jo/. Nëse po, cilat mund të jenë ato?</p> <hr/>																		
6	<p>Cilat kapacitete të stafit mësimdhënës mendoni se duhet të ngriten për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve në institucionin tuaj?</p> <hr/>																		
<p>Pyetjet për Shkollën e AAP-së, FZ, JB, MI, SB; 1 nga 2</p>																			

 Republika e Kosovës Republika Kosovo-Republic of Kosovo Qeveria –Vlada-Government MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION						
7	Sa mendoni se duhet të ngriten kapacitetet e stafit mësimdhënës për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve në institucionin tuaj	Aspak shumë				
		1	2	3	4	5
		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8	Cilët profile konsideroni si më të përshtatshëm apo më të kërkuar në tregun e punës, sa i përket nivelit të pestë?					
9	Me kryerjen e nivelit të pestë të kualifikimeve, sa mendoni se një kandidat do të jetë më konkurrues për t'u pozicionuar në tregun e punës	Aspak shumë				
		1	2	3	4	5
		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
10	A mendoni se institucioni juaj ka kapacitete të mjaftueshme për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve, /Po,Jo/, nëse po, në cilët profile?					
11	Sa është e gatshme shkolla juaj të ofroj nivelin e pestë	Aspak shumë				
		1	2	3	4	5
		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
12	A ka ofruar ose a ofron institucioni juaj nivelin e pestë të kualifikimeve, /Po, Jo/, nëse Po, në cilët profile?					
13	A mendoni se ekziston bazë e mjaftueshme ligjore sa i përket rekrutimit të mësimdhënësve dhe instruktorëve për nivelin e pestë të kualifikimeve?	Aspak shumë				
		1	2	3	4	5
		<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
14	A mendoni se kompanitë me të cilat bashkëpunon institucioni juaj do të jenë të interesuara të thellojnë bashkëpunimin në pranimin e kandidatëve për kryerjen e praktikës profesionale edhe në nivelin e pestë.					
15	Çfarë lloje trajnimesh mendoni se nevojiten për mësimdhënësit që do të ligjerojnë në këtë nivel?					

6. ANALIZA E PËRGJIGJEVE TË PYETËSORIT

Në pyetësor janë vendosur pesëmbëdhjetë pyetje për të cilat është kërkuar përgjigje nga përfaqësuesit e shkollave profesionale në vend. Pyetjet në pyetësor janë nga më të ndryshmet, prej atyre të hapura dhe të mbyllura, ku në rastin e pyetjeve të mbyllura është kërkuar të jepen vlerësime me nivele nga një deri në pesë (1-Aspak; 2-Pak; 3-Mesatarisht; 4-Mirë; 5-Shumë), pastaj është kërkuar të bëhen konstatime me “Po” ose “Jo”, kurse në rastin e pyetjeve të hapura është lënë mundësi përgjigjeje të lira në hapësirat e zbrazura në rastin e secilës pyetje të tillë. Edhe pse shumica e përfaqësuesve të shkollave të cilëve ju është drejtuar pyetësori kanë qenë pjesëmarrës në punëtorinë ku është diskutuar forma dhe përmbajtja e pyetësorit, prapëseprapë ju është dhënë kohë e mjaftueshme që të reflektojnë në dhënien e vlerësimeve, përkatësisht përgjigjeve në pyetësor. Në pyetjet e pyetësorit janë përgjigjur përfaqësuesit e 18 shkollave nga 12 qytete të Kosovës, ndërsa në figurën në vijim janë të paraqitur në hartë qytetet nëpër të cilat janë të shpërndara këto shkolla.

Përfaqësuesit e shkollave profesionale të cilët kanë marrë pjesë në punëtorinë e parë të organizuar nga AAAPARR dhe DVV-International dhe të cilët kanë dhënë vlerësimet e tyre për nivelin e pestë në shkollat profesionale në Kosovë, gjithashtu të njëjtit kanë pas mundësinë që të jenë pjesëmarrës dhe të japin komentet dhe përshtypjet e tyre në punëtorinë e dytë ku është prezantuar draft-dokumenti dhe ju është dhënë kohë e mjaftueshme për të kontribuar në prezantimin sa më të saktë të të gjeturave në këtë hulumtim.




Figura 1. Shpërndarja territoriale e shkollave të AAP-së, pjesëmarrëse në hulumtim.

6.1. “Çka nënkuptoni me nivelin e pestë të kualifikimeve?”, pyetja 1

Përgjigjet në pyetjen e parë të pyetësorit

Përfaqësuesit e shkollave në këtë pyetje janë përgjigjur në përgjithësi në këtë mënyrë:

- kualifikim postsekondar që pajisë kandidatët me shkathtësi të caktuara profesionale,
- zgjerim i njohurive, shkathtësive me programe profesionale, rrit kompetencat e një fushe të caktuar,
- i barazvlefshëm me shkollat e larta me sistemin e mëparshëm të shkollimit, shumë i nevojshëm për shkollat tona, i përgjigjet kërkesave dhe nevojave të tregut të punës, do të vlente vetëm për lëmin profesional,
- në funksion të përgatitjes së nxënësve për punësim si teknik të lartë ose specialist, specializim në profilin përkatës,
- shkollim i avancuar i kualifikimit në një profesion, përmirësim i njohjes së kualifikimeve sipas nevojave të tregut të punës, përmirëson qasjen në vlerësim dhe transferim,
- në përputhje me procesin e Bolonjes dhe përshkruesit e Dublinit për arsimin e lartë, këto kualifikime qëndrojnë ndërmjet arsimit të mesëm të lartë dhe kurseve përfundimtare të nivelit Bachelor,
- me këtë nivel kandidati fiton njohuri të larta në fushën përkatëse dhe është në gjendje të udhëheqë punime për profesionin e caktuar.

Në takimin informues lidhur me hulumtimin të mbajtur me përfaqësuesit e shkollave në punëtorinë e parë, në disa raste disa nga përfaqësuesit e shkollave është kërkuar material shtesë sa i përket njohurive për nivelin e pestë të kualifikimeve, pasi aty u kuptua se niveli i pestë i kualifikimeve nuk ofrohet akoma në shkollat e AAP-së dhe në disa raste mungojnë njohuritë për nivelin e pestë të kualifikimeve. Pas takimit shkollave iu është dërguar material shtesë ekzistues lidhur me nivelin e pestë të kualifikimeve, në mënyrë që të kenë me të qartë punën lidhur me plotësimin e pyetësorit për qëllim të hulumtimit.

Nga përgjigjet e dhëna të përfaqësuesve të shkollave në pyetësor në lidhje me pyetjen e parë shihet se në përgjithësi shkollat e AAP-së kanë njohuri themelore lidhur me dokumentacionin ekzistues që rregullon nivelin e pestë të kualifikimeve.

6.2. “Sa keni njohuri për legjislacionin në fuqi që rregullon nivelin e pestë të kualifikimeve”, pyetja 2

Përgjigjet në pyetjen e dytë të pyetësorit

Pyetja e dytë bënë pjesë në grupin e pyetjeve ku përgjigjet është kërkuar të jepen me vlerësime nga një deri në pesë sipas kësaj renditjeje: (1-Aspak; 2-Pak; 3-Mesatarisht; 4-Mirë; 5-Shumë). Secili nga përfaqësuesit e shkollave të cilëve ju është drejtuar pyetësori kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje.




Figura 2. Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me njohuritë për legjislacionin në fuqi që rregullon nivelin e pestë të kualifikimeve.

Vlerësimet e dhëna nga respondentët në pyetjen e dytë janë dhënë në diagramin e mësipërm, ku vërehet se në përgjithësi (më shumë se gjysma prej tyre) kanë njohuri “mesatare” dhe “të mira” në lidhje me legjislacionin në fuqi që rregullon nivelin e pestë të kualifikimeve. Vetëm në një rast ka përgjigje se nuk ka aspak njohuri në lidhje me legjislacionin në fuqi që rregullon nivelin e pestë të kualifikimeve.

6.3. “A mendoni se është i rëndësishëm niveli i pestë i kualifikimeve?”, pyetja 3

Përgjigjet në pyetjen e tretë të pyetësorit




Figura 3. Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me rëndësinë e nivelit të pestë të kualifikimeve.

Nga përgjigjet e marra në pyetjen e tretë “A mendoni se është i rëndësishëm niveli i pestë i kualifikimeve” mund të konstatohet me të drejtë se ekziston disponueshmëria e shkollave të AAP-së për rëndësinë e implementimit të këtij niveli edhe pse nuk kanë përvojë në zbatimin e tij, deri më tash.

6.4. “Sa mendoni se është i rëndësishëm ofrimi i nivelit të pestë të kualifikimeve?”, pyetja 4

Përgjigjet në pyetjen e katër të pyetësorit




Figura 4. Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me rëndësinë e ofrimit të nivelit të pestë të kualifikimeve.

Vlerësimet e marra nga pyetja e katërt korrespondojnë me përgjigjet e dhëna në pyetjen e tretë lidhur me rëndësinë e nivelit të pestë të kualifikimit. Nga diagrami shihet se shumica e përgjigjeve në pyetjen “sa mendoni se është i rëndësishëm ofrimi i nivelit të pestë të kualifikimeve” shkojnë në favor të vlerësimeve “mirë” dhe “shumë”. Pra, nga kjo shohim se niveli i pestë i kualifikimeve edhe pse nuk është zbatuar deri më tash, rëndësia e tij për të fituar shkathhtësi të reja në tregun e punës është e domosdoshme.

6.5. “A duhet të nxirren akte tjera ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë nivel të kualifikimeve, /Po, Jo/. Nëse po, cilat mund të jenë ato?”, pyetja 5

Përgjigjet në pyetjen e pestë të pyetësorit




Figura 5. Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me nevojën e nxjerrjes së akteve tjeraa ligjore dhe nënligjore që rregullojnë nivelin e pestë të kualifikimeve.

Në pyetjen “A duhet të nxirren akte tjera ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë këtë nivel të kualifikimeve, /Po, Jo/. Nëse po, cilat mund të jenë ato?” pothuajse të gjithë përfaqësuesit e shkollave të AAP-së që i janë përgjigjur këtij pyetësori janë të mendimit se duhet të nxirren dokumente dhe akte të reja ligjore dhe nënligjore që rregullojnë këtë nivel. Vetëm në një rast kemi përgjigje negative që mendohet se mjaftojnë dokumentet ekzistuese që rregullojnë nivelin e pestë të kualifikimeve.

6.6. “Cilat kapacitete të stafit të mësimdhënësve mendoni se duhet të ngriten për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve në institucionin tuaj?”, pyetja 6

Përgjigjet në pyetjen e gjashtë të pyetësorit

Në përmbledhjen e përgjigjeve që kanë dhënë shkollat në pyetjen “*Cilat kapacitete të stafit të mësimdhënësve mendoni se duhet të ngriten për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve në institucionin tuaj?*” ekzistojnë këto vlerësime:

- Mësimdhënësit e mësimit praktik (moduleve praktike),
- Stafi i cili ka përgatitje superiore te duhur duhet të trajnohet dhe certifikohet,
- Duhet t’i nënshtrohen testit vlerësues që të arrijnë një shkathtësi më të lartë praktike dhe metodologji më të lartë të punës,
- Duhet të ngriten kompetenca profesionale e mësimdhënësve,
- Trajnime profesionale mbi teknologji të reja, njohuri në KKK,
- Vetëm kapacitetet pedagogjike, trajnime në fushën e pedagogjisë profesionale,
- Shkathtësi, njohuri, qendrime
- Kapacitetet tona i përmbushin nevojat për nivelin e pestë,
- Trajnimet e përgjithshme profesionale në fusha përkatëse sipas profileve
- Trajnime të vazhdueshme (progresive),
- Furnizim me pajisje dhe një trajnim, pasi shumica e stafit janë me Master.

6.7. “Sa mendoni se duhet të ngriten kapacitetet e stafit mësimdhënës për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve në institucionin tuaj?”, pyetja 7

Përgjigjet në pyetjen e shtatë të pyetësorit




Figura 6. Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me nevojën e ngritjes së kapaciteteve të stafit të mësimdhënësve për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve.

Në pyetjen e shtatë të pyetësorit “Sa mendoni se duhet të ngriten kapacitetet e stafit mësimdhënës për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve në institucionin tuaj?” vlerësimet e dhëna nga respondentët janë dhënë në diagramin e mësipërm, ku vërehet se në përgjithësi (më shumë se gjysma prej tyre) janë përgjigjur “mesatarisht” dhe “mirë” në lidhje me nevojën e ngritjes së kapaciteteve të mësimdhënësve për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve nëpër institucionet e tyre.

6.8. “Cilët profile konsideroni si më të përshtatshëm apo më të kërkuar në tregun e punës, sa i përket nivelit të pestë të kualifikimeve?”, pyetja 8

Përgjigjet në pyetjen e tetë të pyetësorit

Në përmbledhjen e përgjigjeve që kanë dhënë shkollat në pyetjen “Cilët profile konsideroni si më të përshtatshëm apo më të kërkuar në tregun e punës, sa i përket nivelit të pestë të kualifikimeve?” ekzistojnë këto vlerësime për profilet:

- Automekanikë,
- energjetikë,
- informatikë,
- INK,
- Saldator,
- ndërtimtari,
- trafik rrugor,
- transport dhe trafik,
- instalues elektrik,
- mekatronik,
- rrobaqepësi dhe dizajn,
- shitje dhe marketing,
- logjistikë dhe operim në magazinë,
- hoteleri,
- kuzhinier,
- hortikulturë,
- konfeksion,
- veterinar,
- dizajn enterieri,
- fitofarmacit (barnatore bujqësore),
- turizëm,

- operator i makinave me dirigjim kompjuterik,
- tekstil,
- bujqësi,
- teknologji ushqimore,
- pastiqeri,
- metalpunues,
- agrobiznes,
- fermer,
- pemëtari-vreshtari,
- përpunim i mishit,
- bletari,
- përpunim i frutave dhe perimeve,
- profili i doganave.

Duke llogaritur përmendjen e profileve të përmendur në pyetësorët e vlerësuar dhe duke marrë për bazë se cilat profilet më shpesh të përmendura, atëherë konstatohet se përfaqësuesit e shkollave në pyetjen e tetë të pyetësorit (“*Cilët profile konsideroni si më të përshtatshëm apo më të kërkuar në tregun e punës, sa i përket nivelit të pestë të kualifikimeve*”) më së shpeshti kanë përmendur profilet arsimore sipas kësaj renditjeje:

- Informatik (TIK);
- Automekanik;
- Instalues elektrik;
- Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit;
- Ndërtimtari.

6.9. “Me kryerjen e nivelit të pestë të kualifikimeve, sa mendoni se një kandidat do të jetë më konkurrues për t’u pozicionuar në tregun e punës?”, pyetja 9

Përgjigjet në pyetjen e nëntë të pyetësorit




Figura 7. Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me konkurrueshmërinë e kandidatëve në tregun e punës pas kryerjes së nivelit të pestë të kualifikimeve.

Në pyetjen e nëntë të pyetësorit “Me kryerjen e nivelit të pestë të kualifikimeve, sa mendoni se një kandidat do të jetë më konkurrues për t’u pozicionuar në tregun e punës?” vlerësimet e dhëna nga respondentët në janë dhënë në diagramin e mësipërm, ku vërehet se në përgjithësi (më shumë se gjysma prej tyre) janë përgjigjur “mirë” dhe “shumë” në lidhje me konkurrueshmërinë e kandidatëve në tregun e punës, pas kryerjes së nivelit të pestë të kualifikimeve.

6.10. “A mendoni se institucioni juaj ka kapacitete të mjaftueshme për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve, /Po, Jo/, nëse po, në cilët profile?”, pyetja 10

Përgjigjet në pyetjen e dhjetë të pyetësorit

Nga të gjitha shkollat e anketuara për qëllim të hulumtimit, në pyetjen se “a kanë kapacitete të mjaftueshme shkollat për ofrimin e nivelit të pestë të kualifikimeve”, vetëm njëra është përgjigjur se nuk kanë kapacitete të nevojshme për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve. Ndërsa, të gjithë respondentët tjerë kanë shpreh gatishmërinë dhe kanë kapacitete të mjaftueshme në njerëz dhe infrastrukturë për të ofruar këtë nivel në institucionet e tyre. Mirëpo këtu vërehet se varësisht nga kërkesat dhe rrethanat në të cilat funksionojnë këto institucione shkollore të AAP-së, ka edhe kërkesa të ndryshme në plotësimin e kushtëve për të ofruar këtë kualifikim siq janë:

- Trajnimet e stafit mësimdhënës,
- infrastruktura bazuar në profile, kabinetët,
- kushte me të mira për kryerjen e praktikës profesionale, etj.

Ndërsa, sa i përket profileve, edhe këtu kemi një laramani varësisht prej profilizimit dhe asaj se ëfarë ofrojnë shkollat. Në këtë aspekt prinë profilet e lëmisë së makinerisë, ndërtimtarisë dhe elektroteknikës, siç janë profilet: Automekanik, Saldator, Metalpunues, Elektronikë, Instalues elektrik, Informatikë, Ndërtimtari. Tutje kemi edhe profilet tjera si: Ngrohje dhe Klimatizim, Teknologji ushqimore, Mekatronikë, Agrobiznes, Rrobaqepës, Kuzhinier, Tekstil, Veterinar, Hortikulturë, Konfeksion, Dizajn Enterieri, Teknologji e Drurit, Vreshtari, Pemtari, Bletari, si dhe disa profile të Mjeksisë si: Teknik dentar, Optikë, Nutricion, Fizioterapi, etj.

Në bazë të vështrimit të përgjigjeve nga respondentët në këtë pyetje mund të vërejmë se ka kapacitete dhe vullnet në shkolla për të ofruar këtë nivel, por mungon një vizion i qartë institucional në identifikimin e nevojave më të rëndësishme për ofrimin dhe zbatimin e nivelit të pestë, si një komponent i rëndësishëm në sistemin e arsimit në Kosovë, për të

ofruar njohuri, shkathtësi dhe kompetenca të reja te kandidatët që dëshirojnë t’i ngrisin njohurit e tyre konform kërkesave të reja teknologjike dhe tregut të punës në përgjithësi.

6.11. “Sa është e gatshme shkolla juaj të ofroj nivelin e pestë të kualifikimeve?”, pyetja 11

Përgjigjet në pyetjen e njëmbëdhjetë të pyetësorit




Figura 8. Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me gatishmërinë e shkollave për ofrimin e nivelit të pestë të kualifikimeve.

Siç u konstatua edhe në pyetjen paraprake, pra institucionet e AAP-së të cilat janë kontaktuar në këtë hulumtim janë të gatshme të ofrojnë këtë nivel në shkollat e tyre. Kjo shihet edhe në përgjigjet që i kemi marrë në pyetjen e njëmbëdhjetë se ” Sa është e gatshme shkolla juaj të ofroj nivelin e pestë të kualifikimeve”. Vlerësimet e respondentëve përkatësisht institucioneve të kontaktuar të AAP-së, në përgjithësi janë pozitive, prinë me 12 përgjigje të vleresuara mirë, 5 shumë, 5 mesatarisht, 1 pak dhe vetëm 1 aspak.

Komente në këtë pyetje të parashtruar për responentët në pyetsor nuk janë marrë, por në bazë të vlerësimeve që kanë dhënë, pra vërehet se kemi të bëjmë me një gatishmeri dhe kërkesë për të zhvilluar nivelin e pestë në këto institucione duke u bazuar gjithmonë në specifikat e secilës prej shkollave dhe atë se çfarë ofrojnë.

6.12. “A ka ofruar ose a ofron institucioni juaj nivelin e pestë të kualifikimeve, /Po, Jo/, nëse Po, në cilët profile?”, pyetja 12

Përgjigjet në pyetjen e dymbëdhjetë të pyetësorit

Në këtë pyetje vetëm njëra nga institucionet e AAP-së të anketuara nga të gjitha tjerat ka thënë se në institucionin e tyre ofrohet niveli i pestë i kualifikimeve. Është Qendra e Kompetencës në Ferizaj, me profilin e nivelit të pestë, “Asistent për femijë me nevoja të veçanta arsimore”. Të gjitha institucionet tjera të AAP-së, të anketuara në këtë hulumtim, janë përgjigjur se nuk kanë ofruar apo nuk janë duke ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve deri më tani. Kjo për shkak të mungesës së ofertës që kemi deri me tani, për nivelin e pestë të kualifikimeve në Kosovë, mungesës së vetëdijësimit për mundësitë që ofron ky nivel për kandidatët potencial, mungesës së informacioneve për këtë nivel dhe mungesës së harmonizimit të dokumenteve relevante për zbatimin e tij në nivel vendi.

6.13. “A mendoni se ekziston bazë e mjaftueshme ligjore sa i përket rekrutimit të mësimitdhënësve dhe instruktorëve për nivelin e pestë të kualifikimeve”?, pyetja 13

Përgjigjet në pyetjen e trembëdhjetë të pyetësorit




Figura 9. Paraqitja grafike e përgjigjeve në lidhje me mjaftueshmërinë e bazës ligjore sa i përket rekrutimit të mësimitdhënësve dhe instruktorëve në nivelin e pestë të kualifikimeve.

Rekrutimi në punë në përgjithësi është një ndër elementet më të rëndësishëm për të arritur një performancë të lartë dhe sukses, i cili si proces me domosdoshmëri të lartë paraqitet edhe në fazën e implementimit të nivelit të pestë të kualifikimit.

Nga pyetja e parashtruar në pyetësor "A mendoni se ekziston bazë e mjaftueshme ligjore sa i përket rekrutimit të mësimitdhënësve dhe instruktorëve për nivelin e pestë të kualifikimeve?" vërejmë nga përgjigjia e dhënë, e paraqitur edhe në formë grafike se zbrazëtira ligjore lidhur me këtë proces është mjaft e vogël, por nuk është e panevojshme që në të ardhmen të plotësohet infrastruktura ligjore lidhur me rekrutimin e mësimitdhënësve dhe instruktorëve për nivelin e pestë të kualifikimeve.

Vlerësimet e të anketuarve në përgjithësi janë pozitive, duke paraprirë me 12 (dymbëdhjetë) përgjigje me “mirë”, 4 (katër) me “shumë”, 5 (pesë) “mesatarisht”, 3 (tre) me “pak”.

Nga kjo vërehet se në përgjithësi, dhe çdo herë duke i'u referuar përgjigjeve të dhëna nga të anketuarit shohim se çështja e rregullimit të rekrutimit për mësimdhënësit dhe instruktorëve për nivelin e pestë të kualifikimeve aktualisht është mirë, duke mos e përjashtuar mundësinë që në të ardhmen të rregullohet infrastruktura ligjore lidhur me këtë proces.

6.14. “A mendonin se kompanitë me të cilat bashkëpunon institucioni juaj do të jenë të interesuara të thellojnë bashkëpunimin në pranimin e kandidatëve për kryerjen e praktikës profesionale edhe në nivelin e pestë të kualifikimeve”?, pyetja 14

Përgjigjet në pyetjen e katërbëdhjetë të pyetësorit

Bashkëpunimi i instucioneve të cilat ofrojnë ose do të ofrojnë në të ardhmen implementimin e nivelit të pestë të kualifikimeve, me kompanitë të cilat do të mundësojnë edhe më tutje kandidatëve kryerjen e praktikës profesionale edhe në nivelin e pestë të kualifikimeve, është një e mirë e pashmangshme e cila ndikon në realizimin e qëllimit për zbatim të këtij niveli.

Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive mes partnerëve të shkollës kërkon komunikim dhe bashkëpunim mes të gjitha palëve të përfshira, dhe ky komunikim dhe bashkëpunim duhet të jetë në interes të ngritjes së cilësisë, qëllimi i këtij komunikimi dhe bashkëpunimi është të përmirësojë procesin e të nxënës, përvojat dhe rezultatet.

Shumica e shkollave të anketuara, në pyetjen e katërbëdhjetë kanë shprehur mendim pozitiv lidhur me vazhdimin e bashkëpunimit për kryerjen e praktikës profesionale edhe në nivelin e pestë të kualifikimeve, ku 20 (njëzet) përgjigje janë pozitive, 3 (tri)-“mesatarisht” ,dhe me (Jo) është vetëm 1 (një) përgjigje. Nga kjo vërehet se aktualisht ekziston një

bashkëpunim ndërmjet shkollave të anketuara dhe pritshmëria e një bashkëpunimi të tillë besohet edhe në të ardhmen, i cili dukshëm do të kontribuojë në një implementim më të mirë të këtij niveli të kualifikimit, që do të tregojë rezultate dukshëm të mira.

6.15. “Çfarë lloje trajnimesh mendoni se nevojiten për mësimdhënësit që do të ligjërojnë në këtë nivel”?, pyetja 15

Përgjigjet në pyetjen e pesëmbëdhjetë të pyetësorit

Qëllimi i trajnimit është zhvillimi i shkathtësive për mësimdhënie duke ofruar mundësi për zhvillim profesional të mësimdhënësve. Përmes trajnimeve synohet përgatitja e mësimdhënësve për kërkim dhe zbatimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe të nxënit, prandaj edhe është parashtruar kjo pyetje.

Përgjigjet e dhëna nga përfaqësuesit e shkollave janë nga më të ndryshmet, por çdo herë duke e shpreh nevojën për trajnime adekuate aty edhe ku ata mendojnë se janë të domosdoshme varësisht nga kërkesa dhe gjendja e infrastrukturës në shkollë.

Më poshtë e keni të paraqitur një përmbledhje të përgjigjeve të të anketuarve:

- Trajnime në shkathtësi profesionale dhe trajnime në didaktikë profesionale, pedagogji
- Trajnime në teknologji të reja dhe TIK, Trajnime për mentorim, Trajnime mbi kurrikulën dhe standardet profesionale, trajnime mbi njohuritë bazike për KKK,
- Për praktikë profesionale dhe firma ushtrimore,
- Trajnime në pajisje inovative, psh. Teknologjinë e informacionit, instalimeve elektrike,
- Të shikohen modele nga shtetet që e aplikojnë këtë nivel,
- Trajnime më të avancuara për modulet e mësimit praktik,
- Sipas profileve dhe nevojave që paraqiten në treg dhe kërkesave të studentëve
- Të gjitha trajnimet për mësimdhënie dhe nxënie,
- Kurse të avancuara të nivelit akademik, më shumë në pjesën praktike

- Trajnime profesionale sipas profileve,
- Trajnime profesionale,
- Trajnime profesionale të avancuara,
- Trajnime lidhur me njohjen edhe më shumë të këtij niveli, plan-programet, literatura profesionale,
- Trajnime të nivelit profesional dhe didaktik,
- Trajnime specifike që lidhen direkt me përmbajtjen e kualifikimit.

Në bazë të përgjigjeve të marra nga përfaqësuesit e shkollave që i janë nënshtruar pyetësorit për hulumtimin lidhur me nivelin e pestë të kualifikimeve, ata e shohin mëse të nevojshme që mësimdhënësit që do të ligjërojnë këtë nivel të trajnohen kryesisht në profilet adekuate profesionale, teknologji të reja (inovative), trajnime në didaktikën profesionale, pedagogji, mentorim, etj. Mirëpo gjithashtu sugjerojnë trajnime specifike për përmbajtjen dhe mënyren më të mirë të implementimit të nivelit të pestë të kualifikimit dhe literaturë profesionale në mënyre që të arrihet një diapazon më voluminoz për mësimdhënësit të cilët do t'i pregaditin kandidatët në nivelin e pestë të kualifikimit, të cilët do t'i përgjigjen dhe do të jenë mjaftë mirë të përgatitur për tregun e punës.

7. LIDHJA E NIVELIT TË PESTË TË KUALIFIKIMEVE ME INSTITUCIONET RELEVANTE

7.1. Intervistat e realizuara

Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur - Znj. Fikrije
Zymeri, U.d. drejtor i përgjithshëm i AAAPARr-së

Ndihma Daneze për Zhvillim Ndërkombëtar (DANIDA) financuar nga Ministria e punëve të jashtme të Danimarkës nëpërmjet programit “Promovimi i Punësimit përmes Zhvillimit të Biznesit dhe Shkathtësive” në bashkëpunim me MASHT-in që nga viti 2008 -2014 ka mbështetur katër shkolla bujqësore profesionale (Gjilan, Ferizaj, Vushtrri dhe Pejë) me qëllim të rritjes së cilësisë dhe të shkathtësive profesionale të të diplomuarve duke përgatitur ata për tregun e punës.

Fokusi në periudhën 2008-2014 ka qenë në ngritjen e mësimit praktik të nxënësve në formën e përvojës së punës (Internshipit) dhe lidhjet mes shkollave/komunave dhe sektorit privat, do të thotë ka ndikuar në reformimin dhe zhvillimin e sektorit të arsimit të AAP-së në Kosovë në lemin e bujqësisë.

“Zyra e MASHT/Danida ka përgatit të katër shkollat për pjesëmarrje aktive në programin mbështetës BB/Danida si ofrues i kurseve afatshkurtëra të shërbimeve bujqësore për fermerët e synuar”.

Objektiva e mbështetjes së këtij programi ka qenë rritja e kapacitetit të katër shkollave të larta të mesme profesionale bujqësore (Ferizaj, Gjilan, Vushtrri dhe Pejë) për të ofruar një edukim cilësor në pajtim me planprogramet e bujqësisë dhe përpunimit të ushqimit si dhe për angazhimin e tyre në mësim gjatë gjithë jetës, duke e rritur kështu punësimin e të diplomuarve.

Profilet e mbështetura nga ky program kanë qenë: Lavërtari-Perimtari; Pemëtari – Vreshtari; Hortikulturë; Teknologji ushqimore; Blegtori dhe Veterinari, për të cilat janë zhvilluar standardet e profesioneve të aprovuara nga AKK për nivelin e 3-të dhe të 4-të të kualifikimeve. Për keto profile janë të zhvilluara materialet mësimore të cilat mbulojnë 98% të lëndëve të ngushta profesionale, shkollat janë të pajisura me infrastrukturë të nevojshme adekuate (laboratorë, punëtori, sera, plantacione, ferma, etj), kanë lidhje të mira me sektorin privat, trajnim adekuat të mësimdhënësve, andaj mund të konsiderohet se me këto shkolla mund të vazhdohet me nivelin e 5-të të kualifikimeve ku punësimi do të jetë indikator matës.

MAShT/Divizioni i AAPARr/Spektori për arsimin tërëjetësor - Znj. Radica Berishaj

Kualifikimet e nivelit 5, sidomos kur formulohen brenda kornizave modulare të bazuara në kredi, ofrojnë potencialin për të vepruar si porta për shumë destinacione arsimore dhe jo vetëm për një postim të kufizuar në një rrugë të vetme arsimore. KKK-të janë mjete për të trajtuar saktësisht çështje të tilla duke shfrytëzuar një bazë të përbashkët konceptuale në rezultatet e të nxëniet. Përfituesit e kualifikimeve të nivelit 5 duhet të jenë në gjendje që:

- të lëvizin në punësim kuptimplotë;
- ndjekin arsimin e mëtutjeshëm brenda të njëjtës rrjedhë të sistemit arsimor;
- të kalojnë në një rrjedhë tjetër të sistemit arsimor p.sh. tranzit nga fusha profesionale deri tek akademia e arsimit të lartë.

Kualifikimet në nivelin 5 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK) zhvillohen edhe për student/kandidatë si dhe për punëdhënësit. Studentët/Kandidatët tërheqin vlerën e punësueshmërisë së tyre dhe potencialin e tyre për çasje në studime të mëtejshme dhe në

rrugët e tyre të mësimit fleksibël. Punëdhënësit vlerësojnë rëndësinë e tregut të tyre të punës - kualifikimet e nivelit 5 zakonisht lidhen me profesione të caktuara.

AKK/Spektori për kualifikime - Z. Milot Hasangjekaj

Komente mbi zhvillimet e nivelit 5 të KKK nga prespektiva e AKK.

Ligji mbi Kualifikimet Kombëtare rregullon zhvillimin, mbarëvajtjen e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK) dhe dhënien e kualifikimeve në sistemin gjithëpërfshirës të arsimit, deri sa përcakton që Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) ta zhvillon dhe kujdeset për kornizën gjithëpërfshirëse të kualifikimeve pra për sistemin e kualifikimeve. Ky ligj ka për qëllim zhvillimin e sistemit të kualifikimeve sipas hierarkisë të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve nëpërmjet Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në të cilën përfshihet pra edhe niveli 5 i KKK dhe në ndërkohë hap rrugë që kualifikimet në këtë nivel të jenë brenda sistemit kombëtar të kualifikimeve. Për më shumë: https://akkks.rks-gov.net/uploads/ligji_pr_kualifikimet_kombtare.pdf

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve është një dokument që përshkruan qartë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat e secilit nivel nga 1-8, pra që nënkupton dhe nivelin 5. Niveli 5 është i definuar në mes të dy komponentëve të sistemit të arsimit, atë profesional dhe akademik. Po ashtu në këtë dokument sipas treguesve të nivelit përcaktohen: forma e ofrimit formal/jo formal, kohëzgjatja dhe disa nga specifikat tjera rreth ofrimit të nivelit 5. Për më shumë (faqe 31). Për më shumë në <https://akkks.rks-gov.net/kkk/korniza-kombetare-e-kualifikimeve>.

Udhëzimi Administrativ Për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ky UA rregullon dhënien e kualifikimeve profesionale në Kosovë, mbi të cilin AKK zbaton procesin e validimit dhe akreditimit për ofruesit e AAP-së për nivelet 1 deri në 5 të kualifikimeve profesionale. Ky UA përcakton parimet dhe kriteret e procesit të validimit dhe akreditimit, mbi të cilat janë validuar dhe vendosur në KKK disa nga kualifikimet e

nivelit 5, formal dhe jo formal. Dokumente/udhëzues tjere qe mbeshtesin nje forme apo tjeter nivelin e 5 jane:

- Udhëzues për sigurimin e cilësisë të institucioneve të akredituara për të ofruar AAP post-sekondare. Për me shumë: <https://akkks.rks-gov.net/udhezues/sigurimi-i-cilesise>
- Zhvillimi i kualifikimeve modulare;
- Vlerësimi dhe certifikimi në KKK, Udhëzues praktik “Pako e veglave”, etj. Për më shume: <https://akkks.rks-gov.net/udhezues/kualifikimet-dhe-kredite> \

Në proces të zhvillimeve për këtë nivel (5) është kërkesa e drejtuar nga AKK, organizatës Austrian Development Agency (ADA) e cila është implementuese e projektit ALLED II (projekt ky nga BE – IPA), për zhvillimin e një udhëzuesi specifik për nivelin 5. Kjo kërkesë është miratuar dhe është edhe pjesë e planit dinamik të projektit, projekt ky që planifikohet të fillojë në fund të vitit 2018.

Agjencia e Luksemburgut për Zhvillim dhe Bashkëpunim/”Mbështetje reformave të AAP-së në Kosovë” - Z. Blerim Haliti

Projekti Lux Dev

Që nga viti 2003, me avancimin e shkollave të larta pedagogjike dhe teknike në fakultete, përkatësisht universitete, në sistemin formal të arsimit ka pasur boshllëk për nivelin 5 të kualifikimeve.

Në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve, niveli i 5-të është definuar si kualifikim postsekondar/jo terciar, dhe këto kualifikime mund të zhvillohen si akademike apo profesionale. Me funksionalizimin e AKK, disa kolegje kanë zhvilluar këtë nivel të kualifikimit dhe janë akredituar për këtë qëllim. Në sistemin formal të arsimit, me kërkesën e MASHT, të mbështetur nga projekti LuxDev dhe në bashkëpunim me institucionin prestigjioz PEARSON, vitin e kaluar janë zhvilluar dhe kanë filluar të implementohen dy kualifikime të këtij niveli , një në QK Ferizaj dhe tjetri në QK-Prizren.

Ashtu si të gjitha kualifikimet e tjera profesionale, edhe këto kualifikime duhet të respektojnë KKK dhe udhëzuesit përkatës të zhvilluar nga AKK. Duhet të ketë një arsyeshmëri të qartë për kërkesat e tregut të punës dhe duhet të bazohet në standard të profesionit.

Pengesat

Në parim nuk ka asnjë pengesë për zhvillimin dhe ofrimin e kualifikimeve të këtij niveli. Së fundmi, MASHT ka marrë iniciativë për hartimin e një regulloreje/udhëzimi administrative për të qartësuar të gjitha pikat të cilat aktualisht nuk janë të rregulluara me KKK apo dokumentacion tjetër. Pengesë mund të jetë edhe mosdefinimi i pagës së mësimdhënësve sepse kjo kategori nuk trajtohet si e veçantë. Për këtë, Agjencia është në dijeni dhe me urgjencë autoritetet përkatëse duhet të intervenojnë edhe në draft-Ligjin për pagat të futet si kategori dhe t'i caktohet koeficienti meritore. Pervoja në mësimdhënie për të rriturit në IAAP publike mund të jetë një pengesë eventuale gjatë ofrimit të këtyre kualifikimeve, mirëpo kjo mund të kompensohet me trajnime shtesë për mësimdhënësit dhe instruktorët. Pra, në raste të tilla i sugjerohet IAAP-ve një planifikim paraprak të këtij aktiviteti. Dhe krejt në fund, një pengesë jo shpeshherë e mundëshme mirëpo që është vërejtur nga përvoja me dy QK-të (Prizren dhe Ferizaj) është edhe vijueshmëria e kandidatëve përgjatë ligjeratave teorike dhe pjesës praktike pasi që shumica prej tyre ishin të punësuar. Edhe në raste tjera në të ardhmen, prapë të punësuarit mund të jenë audiencë eventuale e ndjekjes së këtyre trajnimeve me qëllim të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të tyre. Andaj struktura ekzistuese të kurrikulës me module teorike praktike e kërkon kujdes të posaçëm të planifikimit të orarit të ofrimit të këtyre lloj kualifikimeve duke pasur parasysh llojin e audiencës së lartëpërmendur.

Kushtet

Nuk ka kushte specifike, përpos infrastrukturës dhe stafit në dispozicion brenda IAAP-ve. Inkurajohen të gjitha IAAP si dhe IAL që të zhvillojnë dhe implementojnë programe të kualifikimit të nivelit 5. Pasi që ky kualifikim ofrohet për të rriturit dhe është jashtë shkollimit të obligueshëm, mundësia për pagesë shtesë për këtë kualifikim do të duhej të

ishte e mundur. Pra, gjenerimi i mjeteve shitesë do te lehtësonte krijimin dhe përmirësimin e kushteve më të përshtatshme.

Relevanca me tregun e punës

Kjo është paksa më komplekse. Pasi që keto kualifikime shpiejnë në specializim të caktuar, hulumtimet mund të bëhen në nivele të ndryshme, por gjithnjë para se ato të zhvillohen duhet të konsultohet edhe sektori privat si dhe odat ekonomike të sektorëve përkatëse.

Instituti Pedagogjik i Kosovës/Sektori i Hulumtimeve/ - Z. Agim Bujari

Në vitin 2015 është hartuar dhe finalizuar një program dokument nga Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK), me titullin “ Trajnimi i Mësimdhënësve të Shkollave të Mesme Profesionale për punë me të rritur”, i cili është i akredituar nga MASHT. Ky dokument mund të shërbejë edhe për zhvillimin profesional të Instruktorëve të Arsimit dhe Aftësimi Profesional (AAP-se), në nivelin e pestë të Kualifikimeve në Kosovë.

Cactus Education - Znj. Vildane Kelmendi

Cactus Education është institucion privat i arsimit të lartë profesional i cili ofron studime të nivelit të pestë të kualifikimeve në fushën e teknologjisë informative dhe të Komunikimit. Janë të akredituar nga AKK dy profile që ofrojnë program dy-vjeçarë për nivelin e pestë të kualifikimeve, dhe atë për:

- Administrues i rrjeteve dhe Sistemeve dhe
- Zhvillues i Ueb-it dhe i Aplikacioneve Mobile

Pra, Cactus Education ofron vetëm profile të teknologjisë informative dhe komunikimit, në harmoni me kurrikulat e Microsoft, Cisco, IBM, etj. Tani është viti i tretë që nga fillimi

i zbatimit të nivelit të pestë dhe tashmë ka diplomuar gjenerata e parë në nivelin e pestë të kualifikimeve. Të gjithë të diplomuarit nga gjenerata e parë janë të përfshirë në tregun e punës, po ashtu shumicës prej atyre që ndjekin nivelin e pestë në të shumtën e rasteve gjatë përfundimit të vitit të parë dhe fillimit të vitit të dytë u ofrohet punë në institucionet të cilat kanë nevojë për kandidatë me kualifikime përkatëse për teknologji informative. Vlen të theksohet se njëri nga kandidatët e diplomuar nga gjenerata e parë ka ndjekur një kohë të caktuar një internship në shtetin e Zvicrrës dhe kompania ku ka kryer internshpinin i ka ofruar punë, një fakt ky që len të nënkuptohet se programi i ndjekur në Cactus Education plotëson jo vetëm nevojat e tregut të brendshëm për Kosovë por edhe është i përshtatshëm me kërkesat e tregut Evropian të punës.

Me të drejtë mund të thuhet se punësuesmeria e studentëve në Cactus Education pas ndjekjes së niveleve përkatëse të kualifikimeve është mjaft e lartë, kjo për shkak të profileve adekuate që kanë relevanc me tregun e punës por edhe për shkak të një politike të mirë të qendrës që kanë në angazhimin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me kompanitë përkatësisht bizneset në këtë fushë.

8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Siç është shënuar edhe më sipër, ky hulumtim fokus të veçantë ka patur analizën dhe hulumtimin e nevojave në teren për të siguruar implemtentimin e nivelit të V-të të kualifikimeve në kuadër të shkollave të mesme profesionale dhe Qendrave të Kompetencës në Kosovë. Në fillim të hulumtimit përmes takimit të përbashkët me drejtuesit e shkollave profesionale është marrë perceptimi i tyre mbi rëndësinë dhe nevojën e zbatimit të nivelit të pestë të kualifikimeve, kurse në fazat e mëvonshme përmes pyetësorit dhe intervistave të realizuara me akterët relevant janë evidentuar gjithashtu mundësitë reale të zbatimit të nivelit të pestë në shkollat tona profesionale.

Nga takimi i mbajtur në fillim me drejtuesit e shkollave dhe nga diskutimet e bëra në takim, përveç tjerash është theksuar edhe nevoja për informim të mëtutjeshëm në lidhje me dokumentacionet e përgatitura nga institucionet përgjegjëse, përkatësisht njëri nga konkluzionet kryesore doli të jetë nevoja për një promovim dhe informim të shkollave profesionale në lidhje me rolin dhe rëndësinë e nivelit të pestë të kualifikimeve, për shkak se deri tani vetëm në dy shkolla publike dhe një shkollë private kanë filluar së zbatuari këtë nivel. Shpesh herë, e ndoshta edhe me të drejtë përfaqësuesit e shkollave profesionale nivelin e pestë të kualifikimeve e ndërlidhin me organizimin e mësimin nëpër ish shkollat e larta që kanë ekzistuar para luftës dhe deri në tre-katër vitet e para pas luftës në Kosovë. Ndërsa prej vitit 2002 e deri në vitin 2015 së pari në institucionin publik në shkollën e mesme teknik “28 Nëntori” e pastaj edhe në kolegjin privat “Tempulli” në Prishtinë dhe auto-shkollën “Profesional” në Prizren është organizuar mësim i ashtuquajtur i shkallës së pestë për shofer-instruktur të automjeteve motorike për kategorinë B. Ky organizim mësimi me kohëzgjatje gjashtë-mujore është realizuar duke u bazuar vetëm në përkthimin e literaturës (përkatësisht materialeve mësimore) nga shtetet e rajonit por nuk kishte një strukturë të qartë të kurrikulave dhe nuk kishte të aprovuara standarde të profesionit për këtë qëllim, ndërsa zbatimi i këtij programi është mundësuar përmes marrëveshjeve të

ndërsjella nga Ministritë përkatëse (MASht dhe ish MTPT tani MI) dhe me lejën e MASht-it. Në tri vitete e fundit ky program ka ndërprerje pasi me përfundimin e kohëzgjatjes së licencave këtyre institucioneve iu është kërkuar përgatitja dhe dorëzimi i standardeve të profesionit për aprovim në AKK, zhvillimi i kurrikulave dhe materialeve mësimore. Deri tani është përgatitur vetëm standardi i profesionit për këtë qëllim dhe është aprovuar nga AKK. Vlenë të theksohet se kërkesat nga ana e kandidatëve për të ndjekur një profil të tillë kanë qenë mjaft të mëdha dhe rezultoni të jetë e nevojshme përgatitja e pakos së përgjithshme të dokumentacionit për të rifilluar organizimin e mësimin për këtë profil në nivelin e pestë të kualifikimeve.

Ndër shkollat profesionale publike që kanë filluar së zbatuari këtë nivel, në njërin nga shkollat (në QK-Ferizaj) tashmë kemi të realizuar me sukses programin e nivelit të pestë për profilin “asistent për fëmijë me nevoja të veçanta”, kurse në shkollën tjetër (Shmlp “Shtjefën Gjeçovi” në Prishtinë) programi i nivelit të pestë për “këshilltar karriere” është në proces të zbatimit normal të tij. Në të dyja rastet kemi të bëjmë me përkrahjen financiare nga qeveria e Luksemburgut, përkatësisht nga Lux-Development dhe përdorimin e moduleve të kualifikimeve nga organizata e njohur ndërkombëtare që ofron kualifikime, e ashtuquajtur “Pearson”.

Ndërsa, në shkollën e lartë profesionale private “Cactus Education” tanimë gjenerata e parë ka përfunduar shkollimin në nivelin e pestë të kualifikimeve në fushën e teknologjisë informative, përkatësisht në profilet:

- Administrues i rrjeteve dhe Sistemeve dhe
- Zhvillues i Ueb-it dhe i Aplikacioneve Mobile

Në takimin e realizuar me përfaqësues të shkollës së lartë profesionale “Cactus Education”, u kuptua se ekziston nevoja dhe kërkesat e tregut janë që të ketë edhe programe tjera të fushës së teknologjisë informative, pasi kompanitë me të cilat bashkëpunon kjo shkollë vazhdimisht janë në kërkim të personave me kualifikime të tilla.

Nga të dhënat e mbledhura përmes përgjigjeve të pyetësorëve, shkollave profesionale i’u është dhënë mundësia të praqesin gjendjen reale dhe të tregojnë mundësitë e zbatimit të

nivelit të pestë të kualifikimeve në varësi të kushteve që shkollat mund të ofrojnë. Gjithashtu, përmes pyetësorit shkollat kanë pasur mundësi të shprehin kërkesat e tyre në lidhje me plotësimin e nevojave të tyre në realizim të trajnimeve për mësimdhënësit apo pajisjen e punëtorive për realizimin e praktikave profesionale.

Sigurisht, programet e nivelit të pestë të kualifikimeve gjatë realizimit të tyre përfshijnë në vete një kosto financiare të caktuar, varësisht nga kohëzgjatja, numri i kandidatëve dhe lloji i profilit asimor dhe kjo kosto financiare pëson ndryshime të theksuara për shkak të nevojës së realizimit të praktikave profesionale me pajisje (mjete konkretizuese) të kushtueshme në disa profile arsimore specifike.

Nga përgjigjet e dhëna në pyetjet e pyetësorit, përfaqësuesit e shkollave kanë dhënë mendimet e tyre në lidhje me të kuptuarit, njohuritë për legjislacionin, rëndësinë, kapacitetet e IAAP-ve dhe stafit të mësimdhënësve, përshtatshmërinë e profileve arsimore me kërkesat e tregut të punës, ofertën dhe gatishmërinë e shkollave për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve, nevojën për trajnime dhe interesimin e kompanive për të bashkëpunuar në organizimin e praktikës profesionale. Kështu, si përfundime dhe rekomandime bazuar në përgjigjet e dhëna në pyetësor janë identifikuar këto të shënime:

- Niveli i pestë i kualifikimeve si kualifikim postsekondar duhet të pajisë kandidatët me shkathtësi të caktuara profesionale, të rrit kompetencat e një fushe të caktuar, të specializon kandidatët në profilin përkatës,
- Për të ofruar nivelin e pestë të kualifikimeve në IAAP-të ekzistuese duhet të ngriten kapacitetet e stafit mësimdhënës në kryerjen më me efekt të praktikës profesionale përmes trajnimeve shtesë dhe certifikimeve, e sidomos trajnime profesionale për përdorimin dhe zbatimin e teknologjive të reja.
- Profilet më të përshtatshëm apo më të kërkuar në tregun e punës, sa i përket nivelit të pestë të kualifikimeve konsiderohen profilet: Informatikë, Automekanikë, Instalues elektrik, Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit, Ndërtimtari, Trafik rrugor, Mekatronik, Rrobaqepësi dhe dizajn, shitje dhe marketing, logjistikë dhe operim në

magazinë, hoteleri, kuzhinier, hortikulturë, konfeksion, veterinar, dizajn enterieri, fitofarmaci (barnatore bujqësore), turizëm, operator i makinave me dirigjim kompjuterik, tekstil, bujqësi, teknologji ushqimore, pastiqeri, metalpunues, agrobiznes, fermer, pemëtari-vreshtari, përpunim i mishit, bletari, përpunim i frutave dhe perimeve, profili i doganave.

Vlen të theksohet se profilet që më së shpeshti janë përmendur si të rëndësishëm dhe për të cilët përfaqësuesit e shkollave kanë dhënë vlerësimet e tyre se janë më të kërkuarit në tregun e punës janë profilet:

- **Informatikë;**
 - **Automekanik;**
 - **Instalues elektrik;**
 - **Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit;**
 - **Ndërtimtari.**
- Profilet për të cilët shkollat kanë kapacitete si në përgatitjen përkatësisht kualifikimin e stafit të mësimdhënësve gjithashtu në posedimin e standardeve të profesionit për nivelin katër, posedojnë hapësirën e nevojshme dhe pajisje bashkëkohore për kryerjen e praktikës në shkollë dhe tashmë kanë hyrë në procesin e akreditimit për këto profile, e që në të njëjtën kohë do të ishte mirë të vazhdohej me nivelin e pestë të kualifikimeve pasi në këto profile tashmë ka disa të dhëna sa i përket nevojës së tregut për to, janë: Automekanikë, Instalues i Ngrrohjes dhe Klimatizimit, Metalpunues, Rrobaqepës, Instalues elektrik, Administrim zyre dhe menagjim, Shitës, Asistent i kujdesit social shëndetësor, Asistent i fizioterapisë, Agjent/agjente turistike dhe informimit për udhëtime, Teknologji ushqimore, Blegtori, Veterinari.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, E SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

